



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 40

Datë: 07. 08. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi. Përkthyesë: Vera Dula

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.28,29 dhe 30/2017:*

2. Aktivitetet e ZRPP-së:

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrimin e partisë politike "Partia URA":

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- Këshilli për Çështje Ligjore:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve të brendshme të KQZ-së;
- Këshilli për Operacione Zgjedhore:

- Shqyrtim dhe miratimi i plotësim ndryshimeve të anëtarëve të KKZ-ve

4. Komiteti i Auditimit:

- Shqyrtimi dhe miratimi i planit të KQZ-së për zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016;

5. Diskutim lidhur me rolin e OSBE-së në zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017;

6. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr. 28-33/2017*

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve...E kemi një agjendë të ngjeshur por, gjithësesi në qoftëse se ka dikush ndonjë vrejje apo diçka... Po urdhëro Betim...!

Betim Gjoshi: Unë mendoj se duhen dy tema për diskutim, në asnjërin nuk duhet vendimmarrje por, duhet angazhim i Sekretariatit besoj në bazë të impenzioneve tona. E para, ka të bëjë me një problem që po na përcjell prej zgjedhjeve në zgjedhje. Ne, po e dërgojmë listën e asambleistave dhe kandidatëve për asamble edhe kandidatëve për kryetarë në Ministrinë e Administratës Publike, e ata po ua ndalin rrogat atyre deri sa të certifikohen zgjedhjet: 3 muaj përpara po ju ndalin, edhe 3 prapa, 6 muaj...Nuk ka asnjë bazë legale, asnjë bazë ligjore, është problematike se si e zgjidhin secili në institucionin e vet këtë punë, dhe asnjëri asnjë nuk e bënë njëjtë... d.m.th., dikujt i duhet të hyj në pushim, dikujt pushim pa pagesë..., kjo nuk është çështje e jona. Por, kisha kërkuar që të diskutohet rreth kësaj, dhe ne të marrim një qëndrim. E dyta, afati për aplikim të partive është në përfundim e sipër. Ne, e kemi pasur një praktik, i jemi drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal lidhur me ndryshin e numrit të asambleistëve prej zgjedhjeve në zgjedhje, të partive...Janë të vogla ndryshimet, por mund të shkaktojnë probleme. Po e zëmë, në qoftëse i bënë 34 kandidatë dhe ne ju themi tash që, “jo 31” meqë ka ndryshuar gjendja siç ka ndoshur që edhe e kemi bërë, ata atje do të kenë problem.

Rreth këtyre dy temave, tha z. Gjoshi, unë mendoj që edhe kolegët do të më përkrahin dhe, kishte qenë mirë që ne të diskutojmë, të marrim një qëndrim rreth tyre dhe të vazhdojmë më tutje...

Valdete Daka: A ka dikush diçka tjetër...? Në qoftëse jo, atëherë kush është për këtë agjendë me këto dy pika shtesë?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalet nga mbledhjet: 28, 29,30,31,32, 33.

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrimin e partisë politike “Partia URA”:

Valmira Selmani (ZRPP), tha se më 11 korrik 2017 Iniciative Politike e quajtur Partia Ura kryesues i së cilës është zotri Sadi Deliq, ka dorzuar aplikacionin në zyrën për regjistrim të partive politike. Zyra brenda afatit ligjorë ka verifikuar dokumentacionin duke e shikuar statutin, programin, aktin e themelimit si dhe librezën e nënshkrimeve , prej periudhës 10 ditëshë e ka përmblyllur afatin për verifikim. Afati ju ka dhënë subjektit politik për përmirësime dhe korrigjime, duke u bazuar ne rregullën 01/2013 brenda afatit kryesuesi i iniciativës ka sjellur përmirësimet dhe korrigjimet. Më pastaj zyra ka shpallur shqyrtim publik në media po ashtu edhe në ueb faqen e KQZ-ës statutin dhe programin si dhe logon e iniciativës prej 27 korrikut deri me 2 gusht. Brenda kësaj periudhës nuk kemi pasur asnjë ankesë nga qytetarët. Zyra gjatë periudhës të cilën e ka publikuar në ueb faqen KQZ-ës ka përfunduar, më pastaj zyra ka përgaditur rekomandimin dhe rekomandim për regjistrimin e kësaj initiative politike në regjistrin e partive politike, pas aprovimit nga ana e KQZ-ës duke u bazuar në neni 12.3 dhe 12.5 të ligjit për zgjedhje të përgjithshme. Në qoftëse kjo iniciativ merr miratimin nga KQZ-ja do të hyjë në regjistrin e partive politike me emrin Partia Ura dhe do të renditet me numër 61...

Valdete Daka: E kemi pasur edhe dokumentacionin në emailat tonë... Nëse nuk ka dikush vërejtje, diskutim...? Atëherë kush është për regjistrimit të këtij subjekti politik?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan rekomandimin e ZRPP për regjistrimin e subjektit partiak Ura.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

1. Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve të brendshme të KQZ-së

Sami Hamiti: Në tri mbledhjet e një pas njëshme të Këshillit për Çështje Ligjore apo në një mbledhje e cila është vazhduar tri ditë radhazi, kemi shqyrtuar edhe miratuar në kuptimin e asaj ase, e kemi dhënë vizën që të vinë për KQZ-ë pesë rregullore të cilat, i kemi punuar edhe në grupin punues për çështje ligjore...U është dhënë viza që të pestëve që të vijnë në KQZ, dhe rekomandim i këshillit është që të votohen në KQZ.

Valdete Daka Atëherë, e kemi Rregulloren nr. 1/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka dikush me na dhënë shpjegim...?

Enis Halimi: Jo shpjegim kryetare por, për të përcjellur një plotësim prej asaj që e kemi evidentuar, këto grupet tona punuese, jo unë personalisht, te asistenti i Logjistikës ku bëhet fjalë për një pozicion...Grupi, pas mbledhje ka konsideruar ose vlersuar se ai duhet të lëshohet më poshtë dhe jo në nivelin ku është tash... Bëhet fjalë pra për neni 30, ku është tash...e që të vendoset të neni 31 të niveli administrativ numër 1. Kjo është pjesa e parë, ndërkaq për sa i takon asj unë edhe njëherë para jush mendoj që ja vlen ndoshta të konsiderohet propozimi im në mbledhjen e Këshillit të Qështjeve Ligjore që ka të bëjë me divizionin, krijimin e një divizionit brenda Departamentit të Teknologjisë Informative, kur e kemi parasysh se rëndësinë që po e merr dita ditës kjo çështje, pra, Teknologjia e Informacionit në procesin zgjedhorë. Pra, kjo është si propozim në Këshillë, është diskutuar nuk është që ka qasur ndonjë qëndrim mbështetës, megjithatë unë po e paraqesë edhe një herë kështu prej juve që është besim i joni që mos askund tjetër bile në teknologji ja vlen të strukturohet pak më mirë.

Valdete Daka: Neni 21, departamenti i TIK. Çfarë ndryshimi dëshiron të bësh? Çfarë propozimi?

Ilir Gashi: Sa persona janë aty?

Sami Hamiti: Si po propozon ti? Drejtor i departamentit është 1, dhe janë 3 pozita.

Enis Halimi- Njëri prej tyre me shërbyer edhe si shef i divizionit, taq zam, për zhvillim të softëereve dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve. E kemi një pozitë të propozuar, për të cilën në të ardhmen do të interesohemi që ta plotësojmë, por besoj që është e udhës që për me funksionalizuar më mirë me e vendosë një divizion brenda për brenda. Ky ka qenë propozim i imi në këshill dhe ndiva obligim që ta prezantoj edhe këtu.

Betim Gjoshi: Kryetare, unë kam dëshirë me qenë i singjertë. Nuk ka qenë një propozim, kanë qenë dy. Ka qenë edhe një në ZRPP, por ka qenë qëndrim i të gjithëve që ideja e jonë si KQZ është ka shuarja e divizionit, jo nga rritja... Nuk është që prodhon emertimi divizion, sepse pagat i kemi krijuar shumë më të mëdha se divizionet, e këto “armatat e pesta” që i kanë pasur... Po përpiqemi me krijuar një trupë profesionale, jo shefa... Po shtohen edhe 2 shefa, po bëhen 30 dhe 12 punëtorë. Nuk po i mbetet as nga një punëtorë me menaxhuar. Ky ka qenë qëllimi i të gjithëve dhe unë nuk besoj, vetëm është mirë me na treguar çka kanë prekë nga rregulloret prej asaj që kemi miratuar në KQZ. Kjo është më me rëndësi, sepse po e shoh që ka prekje

Vahide Behrami: Kjo ndërhyrje është bër te rregullorja për përshkrimin dhe klasifikimin e vendeve të punës. Një sqarim të shkurtër. Te premtën drejtorët e departamenteve se bashku me mu i kemi finalizuar përshkrimet e vendeve të punës dhe kemi ardhur në përfundim, normal formalizimi është bër konform rregullores për pelqim te vendit të punës që janë pjesë e kësaj rregullore, dhe u vendos që asistenti i logjistikes të jetë në nivel të barabartë me vozitësin, e jo sikur tani që është në nivel të barabartë me dz asistentet ekzekutive dhe zyrtarin e lartë të arkivues.

Adnan Rrustemi: Së pari po du me ba qëndrimin tim të njohur për komplet rregulloren, për organizimin e brendshem të sekretariatit. Unë kam qenë kundër edhe në punëtori, kam abstenuar edhe në këshill për çështje ligjore, nuk do ta përkrahi as këtu. Jo për ndonjë vërejtje specifike të rregullores, sepse unë e kam vetëm vlerësimin e përgjithshem. Mendoj që, si institucion i ka munguar një analizë nga sekretariati mbi mënyrën e funksionimit të sekretariatit, performancën e njesive një për një, mundësitë për tu avancuar, për me u zhvilluar sektorët eventual, për me pa kush ka kapacitete me u ngritë dhe kush eventualisht nuk ka kapacitete me e ushtruar detyrën aktuale. Është dashur me u shfrytëzuar, për fat të keq nuk është shfrytëzuar situata. Unë, e kuptoj që kjo është ë ndryshueshme dhe nuk është e shënjtë, por megjithatë nuk është në korrelacion me vërejtjet, vlerësimet që i kemi dhënë për sekretariatit, ose së paku nuk ka shkuar në drejtim të njëjtë.

Ne, tha z. Rrustemi, ish dashtë me pa gjendjen e funksionimit të Sekretariatit, dhe kjo rregullore me iu përshtatë kësaj gjendje. Diku me e permisuar, diku me levizë pozicione, ma lartë ma poshtë. Ne ish dashtë me pa edhe ku ka hapsirë për më u zhvilluar kapacitetet në sekretariat dhe ku nuk ka. E kanë mbërritur cepin e mundësive tyre. Në parim mendoj që ka ardhur, nuk është shumë e natyrshme për gjendjen. Ndërsa, sa i përket propozimeve të kryeshefit, vërtet kanë qnë dy propozime por, e para ky propozimi për IT mua sot po më tingëllon më ndryshe se sa Këshillin për Qështje Ligjore. Në Këshillin për Çështje Ligjore, propozimi sikur të themi themelimi i një divizioni të ri brenda departamentit për inovacione apo diçka të till në këtë drejtim. Ndërsa, sot po paraqitet si instrukturim paka a shumë të departamentit aktual. D.m.th. në parim unë nuk jamë kundër ristrukturimit të departamentit brenda me këto pozicione që janë, nëse e vlerësoni që e rrit efikasitetin, ndahen detyrat më mirë ose ekzistojnë natyrë e ndryshme e punëve brenda këtyre zyrtareve por, kemi qenë kundër është e vërtet për një themelim kështu për një vizion të ri jashta pozicioneve. Edhe ajo që tha Betimi është e vërtetë ne faktikisht nuk është që e kemi refuzuar kategorikisht por, këtu jemi nxitu nga fryma që pagat në rregulloren tjetër janë renditur jo domosdoshmërisht në përputhje me pozitën, sa në përputhje me fushën, me natyrën e punëve, d.m.th., ka rast kur zyrtarë të caktuar përkundër pozitës, e kemi përcatuar pagë, se nuk e di a kanë pasur mundësi me marr, shumë më të lartë se sa pozicioni dhe diku tjetër e ka pozitën ndoshta emërtimin por në ndërkohë e ka pagën sa ai zyrtari. Është mirë të dimë se cilën linjë ta ndjekim: A po e ndjekim linjën e emërtimeve të pozicioneve a po e ndjekim linjën e shpërblimit në përputhje me specifikat e punës me atë që kemi thënë vazhdimisht që fusha e zgjedhjeve zyrtarëve , specialistëve të stimulohet e të nxitet.

Betim Gjoshi: Tendanca që neve anëtarëve të KQZ-ës me na prish me dikënd prej stafit. Por, ne i kemi pasur qëndrimet e qarta, ne nuk kemi folur për njerëz nuk folim për individ, i kë të gjitha operacionet zgjedhore me operacione të tjera. Mesatarisht të gjithve ju është rritur rroga 60%. Hiq shefin auditimit, kryeshefin dhe zëvendskryeshefin asnjë nuk e ka nër 60%, ju shkon 70 e diçka përqind se harrova të themë paga, do të thotë deri 98 e diçka i shkon drejtoreshës së zyrës për regjistrimin e partive politike, por, tash ka tendenca te dikush edhe pse ju ka rritur 60% po kërkon 80% se përpara thonë kam qenë barabartë me ata. E ne kemi mbajtur qëndrim shumë të

qartë përfshirë edhe procesin e asistentin e logjistikës, se asistent i është dukur dikujt ne mun edhe ta emërojmë zyrtarë mund ta emërojmë edhe zyrtarë i lartë edhe shef divizioni por, ai do të kryej një punë të logjistikës edhe e kemi vlersuar si proces zgjedhorë në kohën kur e kemi bërë rregulloren. Edhe e dyta, që mos ta marr më fjalën kanë lëvizur pagat prej ditës që i kemi miratuar në listë nuk janë përmirësuar në rregullore, ju kanë rritur edhe pagat. Kryeshef ju kanë rritur edhe atyre që keni propozuar që ju ka rritur grada, e që nuk ju rrit tash grada ju ka mbetur e njejtë por paga ju është rritur. Pse po na sjellni neve punën që të flasim për njerëz d.m.th., ne kemi marr një qëndrim d.m.th., këtu duhet të propozohet, i kemi propozimet e këshillit, ju nuk është dashur të merreni me këto rregullore fare edhe neve nëse keni propozime që nuk ju kanë kaluar në këshill qitni në KQZ-ë por, vetëm trgon pse nuk ju kemi kaluar në këshill d.m.th. jo që kemi pasur diçka personale me dikënd por, kemi trguar sakt. Si kanë mbërrir ti marrin gradat e kaluara neve nuk na intereson, neve po na interson askujt nuk ja kemi zvogëluar rrogën, 60% është minimumi që dikujt i është rritur dikujt ka 98% që ju është rritur dikujt të gjithë janë të kënaqur ? Po flas kryeshef në këtë rast që, ta bëjë më të qartë juve pikën tre d.m.th. në list e keni, shikoni listën grada nuk përputhet me pagën d.m.th. e keni ngritur në mënyrë fiktive atë që ka dashur, e keni futur edhe në përshkrim në vende të punës që na keni sjellur sot para vetit d.m.th. edhe atë. Edhe çka po dua të them, e fundit, ne i kemi paraparë disa pozita të planifikuara ju kisha thënë futeni edhe ZKF-en ju kam thënë edhe atë ditë në takim është mirë ta kemi të planifikuara se ligje e kërkon. Kur ta emëroni ZFK-ën lëreni por, nuk mund të trajtohet si drejtorat e tjerë barabartë. ZKF-ja paralelisht shkon me zëvendkryeshefin me këta personat tjerë që janë auditorë , drejtoreshë të zyrës e ku ta di unë. Është pozicion ligjorë që ligji ja përcakton gradën si ja përcaton edhe auditorit edhe të tjerëve. Unë kaq pata, por e kisha lut kryetaren prej rregullores së parë se, nuk janë qëndrimet e njëjta për të gjitha rregulloret, mi marr një nga një t'i miratojmë.

Valdete Daka: Unë, e kamë vetëm edhe një pyetje shumë të thjeshtë: Pse merr pjesë stafi në mbledhje të KQZ-ës? Përveq atyre që është e nevojshme...? Kur kanë me prezantuar po, por, kur nuk kanë shumë më intereson pse marrin pjesë apo vetëm për ti trajtuar qështjet KQZ-ës pastaj në qështjet kuleare të sekretariatit. Kjo praktikë ka qenë dhe vazhdon me qenë me mebtë shqetësuese për mu, sepse stafi i ka punët e veta. Ne nuk shkojmë me marrë pjesë atje ku stafi i kryen punët e veta. Nuk shkojmë me i pa çka bëjnë. Dhe ne, mendoj që nuk është në rregull stafi i KQZ-së që nuk ka pika të rendit të ditës me qenë këtu. Nuk ka nevojë. Nëse ka diçka, në rregull. Kur është një fushë e atij, por pjesa tjetër unë nuk e kuptoj pse marrin pjesë.

Adnan Rrustemi: Kujtoj debatin për rregulloren e punës... Ju, vetëm duhet me respektuar rregulloren e punës. Nuk më pengon prania e asnjë sizratri, por një gjë është e vërtetë. Në radhë të parë devalvohet puna e KQZ-së, dhe e dyta, kjo për mu është indikatorë se si kryeshefi dhe menaxhmenti, ne pamundësi ose padëshirë për me i absorbuar përgjegjësitë që i takojnë për secilin sektorë po e kanë çdo herë më te lehtë me i shpërnda te yzratrët përkatës. Unë nuk jam kundër zyrtarit, unë kam qenë kundër për me ia dhënë pozitën e merituar kryeshefit, unë kam

qenë kundër edhe me raportuar zyrtarët. Zyrtarët duhet me raportuar te kryeshefi, këtu në seancë të KQZ-së duhet me raportuar kryeshefi.

Unë, tha z. Rrustemi, nuk e vlerësoj punën dhe përformancën e zyrtarit, as mënyrën e raportimit... Unë të kisha qenë zyrtar, kisha refuzu me raportuar në KQZ. Duhet kryeshefi me raportuar, as drejtorët jo. Le t'i merr përsiper punët e veta. Se kjo i involvon me i njofto pastaj edhe operacionet. Unë nuk e kam problemin që me pengon raportimi i asnjë zyrtari, por mua me duhet një kryeshef që involvohet në operacione zgjedhore në secilën çështje, e mënzra e vetme për me u involvuar është me i marrë përsiper me i raportuar. T'i apstrahojmë anëtarët e KQZ-së kush janë, e kush nuk janë... Është seancë që reflekton kuvendin. Duhet këtu me pasë diskutim dhe këtu është përgjegjes vetëm kryeshefi dhe drejtoresha për përgjegjësitë e saj. Asnjë tjetër. Këtu le ti merr detyrat kryeshefi. Le të i dekoncentron e decentralizon dhe le të i mbledh informacionet nga njesitë e veta dhe le të raporton. Kjo duhet me qenë standard, sepse pastaj po shpërndahet përgjegjësia. Pastaj kryeshefi me anëtarët e KQZ-së po i degjon raportimet e zyrtarëve për herë të parë...

Valdete Daka: Unë po pyes, a ka nevojë stafi që nuk ka punë me qenë pjesë e mbledhjes së KQZ-së dhe me i ndëgjuar deklaratimet e anëtarëve dhe mandej me i percjellë dhe me i shqyrtuar në zyrat e sekretariatit. Pse marrin pjesë nuk e kam të qartë ende. Zyrtarët kanë punë tjera për çka paguhen. Nuk paguhen me ardhë me nejt këtu si publik.

Adnan Rrustemi: Mendoj që edhe autoriteti i kryeshefit rritet edhe para zyrtarëve sikur komunikimi midis zyrtarëve dhe KQZ-së e kish ba kryeshefi. Kur ia kish plasuar qëndrimet dhe vendimet kish me qenë serioze edhe mënyra si adresohen punët dhe realizimi i projektit.

Ilir Gashi: Është një pikë që po e mbeshtes. Edhe në këto momente kur ne mbajmë mbledhje, administrata duhet të ketë punë, dhe është tërsisht e panevojshme. Madhje, në rrethana që jemi edhe sikur të kish pas me raportuar është mirë me e deleguar te kryeshefi. Edhe kryetarja është mirë me qenë më e vëmendshme që me kërkuar që çdokush që nuk ka të bëjë me mbledhje me dalë jashtë, sepse nuk ka nevojë me qëndruar, por duhet të jetë edhe kryeshefi i vëmendshmëm që as drejtorët, ata të cilët nuk kanë pikë të rendit të ditës, nuk kanë nevojë me qëndruar. Krijon seriozitet më të madh të mbledhjes edhe të mbarëvajtjes së punës, por edhe të kryeshefit.

Valdete Daka: Kjo vlenë edhe për sot, sepse sot janë mbledhë stafi me ndëgjuar kush çka po folë për rregullore. Unë, kisha kërkuar krejt ata që nuk kanë punë sot me dalë prej salle, vetëm ata që janë të obliguar sipas ligjit me qëndruar...

Eshref Vishi: Faleminderit, kryetare! U hap një pikë tjetër e rendit të ditës që është e rëndësishë së vet edhe kjo, mirëpo unë po dua të ndërlihem me rendin e ditës, dhe pikat e rendit të ditës... Është fakt që këto plotësime ndryshime që janë bërë nuk kanë rrjedhë nga një analizë funksionale që është kërkuar. Është kërkuar një analizë funksionale sekretariatit dhe mbi bazën e analizës të bëhet edhe plotësime ndryshimi. Kjo nuk ndodhi, mirëpo unë jam për atë që përgjegjësit le të i referojnë çështje të cilat i ka ndryshuar nga takimi i Tiranës në këshillin për personel. Dhe nga

këshilli i personelit këtu, ne si anëtarë duhet me i ditë të gjitha ndryshimet të cilat janë bërë dhe është mirë që mos të kalojnë heshtazi këto ndryshimet të cilat janë.

Betim Gjoshi: Kryetare, ne nuk kemi bër ndryshimë , ne jemi munduar me e kthyer situatën qysh ka qenë në Tiranë. Sekretariati është munduar me i bë disa ndryshime. Po tregoj cilar janë dhe i kemi përkrahur. E para, ne i kemi pas bërë 4, 5 funksione të larta zgjedhore barabartë me drejtora. Këta kanë kërkuar me i ulë këta, me i bë nëndrejtora. Ne drejtorat i kemi ngritë, këta i kemi lënë në të njëjtën shkallë. Shërbimin votues, logjistiken, QNR-në i kemi lë me paga të drejtorave. Përveç kësaj e kemi menudar edhe një fazë tjetër. Kur hypin gradat në fuqi të qeverisë nuk e dijmë. Ua kemi rritur koeficientin për me i arritur këto grada. Po e zam, një drejtor nuk ka me pas koeficientin 10, por 16. Një zyrtarë që e ka pasur koeficientin 8 nuk ka me pasur 8, por 14. I kemi zbërthyer si fazë kalimtare deri në hyrjen e gradave në fuqi, i kemi rritur koeficientin me u përputhur me grada. Ka ndodhur edhe një gabim, ku e kemi përmusuar te lista. Listën me e përshtatë me rregullore. Dhe, po du me plotësuar këtë që nuk ka pasur analizë. Rregulloret me këto propozime kanë ardhur si kërkesë e sekretariatit, nuk kanë ka qenë kërkesë e jona. Nuk ka qenë prioritet me u ndryshuar . këta i kanë futur në plan të punës. Ne vetëm i kemi fuqizuar disa role të zyrtarëve zgjedhorë. Dhe mendoj që e kemi bër hapin ma të madh që është dashur KQZ me bë që 10 vite, që nuk mundet me trajtuar njëjtë si zyrtarin e financave si zyrtarin e listës votuese. Nëse mendeni me vazhduar një nga një.

Valdete Daka: Rregullorja e parë është 01/2017. Kryeshefi i dha disa sqarime, mirëpo prej asaj që kuptuam prej këshillit për çështje ligjore, në ndërkohë kanë ndodhur disa ndryshimë të cilat nuk janë miratuar në këshill. Ka ndodhur në raport me Tiranën.

Enis Halimi: Stafii, e ka evidentuar që pozita e asistentit të Logjistikës me dalë nga grada administrativ 2, në 1. Dhe, ky propozimi im që ka qenë në këshill të çështjeve ligjore, që te IT-të me shikuar mundësinë e ristrukturimi më ndryshe, me krijuar një njesi brenda saj. Kjo është...

Valdete Daka: Kjo, pozita e Asistenti i Logjistikës...

Betim Gjoshi: Te rregullorja e dytë është...!

Eshref Vishi: Kryetare, i kam disa vërjetje të karakterit teknik. Te parimet, është standard që të respektohet nga administrata sa i përket radhitjes parimet mbi të cilat organizohet puna e administratës. E këto janë: ligjshmëria, pavarësia, paanshmëria, profesionalizimi... Jam për ata që të futet edhe profesionalizmi, efikasiteti dhe efektiviteti. Teksti, kështu: Ligjshmëria, profesionalizmi, paanshmëria dhe objektiviteti, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti, koordinimi dhe kontrolli i realizimit të detyrave. Dhe, propozimi im është që 3 pozitat fundit: Zyrtari i Lartë Certifikues, Zëdhënsi i KQZ-së, neni 26,27,28, dhe Asistenti i Kryetarit të KQZ-së, këtu, thuhet se detyrat dhe përgjegjësitë caktohen nga kryetari, respektivisht KQZ, ndërsa sa i përket çështjes administrative i përgjigjet krzeshefit të ekzekutivit, atëherë këto tri pozita... pse nuk barten si rengim tek zyra e krzeshefit ekzekutiv masi ato veq aty pergjigjen dhe ai i mbanë në kontroll.

Valdete Daka: Të gjithë punëtorët i përgjigjen, administrativ i përgjigjen kryeshefit, nëse s'kemi diçka tjetër...!

Eshref Vishi: Kryetare, ndoshta komisioni e ka pasur parasysh këshilli vërtet nënin 4 kompetencat dhe përgjegjësitë e sekretariatit për mendimin tim e kisha hjek këta për arsye se ato përgjigjisi edhe kompetencat përshkruhen edhe në nënin 7 për përgjigjisi të sekretariatit, nëni 4 mu heqë për arsye se kompetencat e përgjigjësit janë në nënin 7...

Valdete Daka: Atëherë, kush është për me këto ndryshime...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan ndryshimet e rregullores nr. 1.

Valdete Daka: Vazhdojmë me rregulloren e dytë...! Shkojmë me rregulloren numer 2 përshkrimin e detyrave të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës në sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, po urdhëro Sami, a ki diçka me thanë ti...!

Betim Gjoshi: Na, e kemi n'i Sekretariatit me 88 pozita të miratueme me ligj të buxhetit, e kjo e asistentit është një planifikim për të ardhmen... Krejt debati është bërë dhe, problemi te kjo që ka me ndodh po..., kjo s'ka me ndodh kurrë pa u plotësuar këto 7 që i kemi, jo ajo e asistentit që nuk është kërkund... Kryetare, në mënyrën si është, nuk po ia prishim Sekretariatit. E miratojmë këtë rregullore, vetëm këtë tabelën le ta përshtatin me rregulloren. I ka dy gabime, ndoshta ma shumë... Tetëshin e ka gabim. Nuk e ka në përputhje me rregulloren. Pesmbëdhjetë e ka në rregullore, këtu po shkruan 16...!

Valdete Daka: Përshtatni me rregulloren...Vazhdojmë. A ka diçka tjetër...?

Betim Gjoshi: Unë e pata edhe për Zyrтарin Kryesor Financiar por nuk gjeta mbështetje...Për ZKF-në..., pozicion i planifikuar le të jetë te grada e Zv-Kryeshefit...Është zyrtari kryesor financiar...

Valdete Daka- Në rregull. Vendoseni.

Sami Hamiti- Duhet me vendosë nën zvendësin në një pozicion, duhet me i dalluar. Zyrtari kryesorë financiar, ku ka kryeshef, zv.kryeshef, pastaj vijnë me atë normen... Është në mesin e tri pozitave të larta...

Valdete Daka: Kush është për me ZKF-në?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan edhe rregulloren e dytë (2)

Valdete Daka: A ka kundër? Nuk ka...?

Adnan Rrustemi: Këto përshkrimet cila me cilën shkojnë? Me të dytën, a?! U ndjekë një shabllon, ku bën fjalë për format e përshkrimit të detyrave të punës. U ndjekë një shabllon ku bën fjalë për kualifikimet, diplomat universitare, drejtësi, shkenca politike, administratë publike.

Në shumicën e pozicioneve në të cilat kur të ia shohësh përshkrimin e detyrave të punës jodomosdoshmërisht korrespondojnë. Unë e mora vetëm zyrtarin e lartë të listës votuese. Edhe prej përvojës po e tham, por edhe prej përshkrimit që ia keni bërë, merreni edhe lexojeni, ka me punuar në krijim të listës votuese, ka me i ndihmuar zyrtarit të databazës, ka me punuar në operacion të regjistrimit të votuesve jashtë vendit, dhe e ke thanë shkenca politike, drejtësi, administratë publike. Për mu, së pari nuk janë relevante, e dëzta nuk janë të mjaftueshme. Aty më shumë ka nevojë për një zyrtarë të IT sesa për një politolog. Edhe zyrtari për regjistrim të partive politike, e njëjta gjë. Këto duhet me i shikuar edhe një herë.

Valdete Daka: Shkojmë me rregulloren e tretë: Procedurat e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve që rekrutohen në Sekretariatit e KQZ-së.

Nëse nuk ka vërjetje, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rregulloren e tretë (3)

Valdete Daka: Shkojmë me rregulloren e katërt: Avancimi në karrierë dhe transferimin e nëpunësve në Sekretariatit e KQZ-së. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rregulloren e katërt (4)

Valdete Daka: Kodi i mirësjelljes për stafin e Sekretariatit të KQZ-së...? Në rregull është...! Për stafin e komisionit, kurse në serbisht e keni bërë keq... Me këtë vërejtje, “Kodi i mirësjelljes për stafin e Sekretariatit të KQZ-së”...Kush është për me këtë ndryshim?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rregulloren e pestë (5)

4.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtim dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të anëtarëve të KKZ-ve

Valdete Daka: Shkojmë me pikën tjetër...Urdhëro...! Vetëm pak Adnan...! Përshkrimet në mbledhjen tjetër...!

Sami Hamiti: Përshkrimet, kushdo që ka vërejtje t’i përcjellë...!

Adnan Rrustemi: Këtu e ka mundësinë kryeshfi me sidomos në pozita të lira, se na duhet me bër një balancë edhe të drejtimeve. Këtu është mundësia kryeshefi me vu dorë...

Ndërkaq, tha në vazhdim z. Rrustemi, KOZ-i ka shqyrtuar disa çështe: E para, është plotësimi dhe ndryshimi i dy anëtarëve të KKZ-së, respektivisht në Prishtinë, por në shumë dokumente unë nuk po mundem me e gjetë listën... Bëhet fjalë për dy anëtarë në KKZ në Prishtinë... LVV dhe PDK kanë kërkuar zëvendësimin e dy anëtarëve, këshilli i ka shqyrtuar, sekretariatit i ka vlerësuar që janë në përputhje me ligjin, dhe ne i rekomandojmë KQZ –së për me e miratuar ndryshimin...

Betim Gjoshi: Kryetare...! Ne, nuk po emërojmë të ri por, vetëm po i zëvendësojmë dhe për këtë as kritere nuk kemi..Por, ajo që është me rëndësi, nëse iu ka bërë trajnimi KKZ-ve nuk është mirë me pranuar prapë ndryshime... Nuk ka në ligj afat që përcakton kur bëhet ndryshimi, por partitë e kanë kur e emrojnë, por nuk mundën në proces zgjedhorë me i ndërruar... Nëse e ka humbë kriterin që nuk ka të drejtë me qenë në KKZ, por me i ndërruar për qejf, nuk është mirë. Ne, po investojmë në ta, dhe, partitë nuk ka qenë mirë me i zëvendësu...

Sami Hamiti: E ka ndërruar VV në Prishtinë, edhe ne e ndërrojmë...

Adnan Rrustemi: Nuk mundemi në mënyrë arbitrare. Ne, duhet me i vendosë paraprakisht disa parime dhe me i njoftuar edhe subjektet politike, qoftë edhe përmes nesh se në cilat raste mundën. Po e zë kandidati i VV-së e ka humbur të drejtën, sepse kandidohet për asamble. Unë pajtohem që me u munduar me i vendosë disa standarde deri në cilin rast...

Valdete Daka: A kanë trajnim ekstra...? Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së votuesve të lagjes së Suhudollve dhe të lagjes së Doktorëve për të votuar në komunën e Mitrovices së Jugut

Adnan Rrustemi: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së votuesve së lagjes së Suhudollve, e poashtu edhe e lagjes së Doktorëve për të votuar në komunën e Mitrovices së Jugut...Epo, nuk është vetëm çështja e kërkesës por, është edhe një çështje që është dasht edhe Sekretariati edhe ne vet, me e bërë një vlersim të gjendjes atje...Unë, për fat të keq nuk e morra harten ligjin për kufi administrativ të komunave dhe të antarëve që besoj se e kanë të qartë, në bazë të ligjit të kufijëve administrativ zona kadastrale “Suhudoll I”, i takon komunes së Mitrovices së jugut ndërsa, zona kadastrale “Suhudoll II” e cila nuk ka banorë, vetëm territori i takon komunës së Mitrovices së veriut sikurse edhe kjo lagja tjetër që, ishte lagjia e Doktorëve që i përket Mitrovices së veriut në kohën kur u ndanë. Mitrovica, në dy komuna sikurse edhe në gjdo komun tjetër nga decentralizimi një votues e ka pas të pa mundur me i nda edhe me i percaktuar në komunën përkatëse sepse, nuk ka pasur të dhana nga komuna e krijume. Është komunë që nuk ka ekzistuar që, s’ka pasur qendër të Regjistrimit Civil që s’ka l’shu dokumente, e kështu me radhë...Do të thotë, është dashtë me e b’ a njëfar ndarje, d.m.th., manuale të votuesve në bazë të disa kritereve sekondare...

Në bazë të disa kritereve sekondare, tha z. Rrustemi, kërkesa e banorëve në rastin apo në këtë rastë, Qendra e Votimit në Suhudollë ka qenë “38” me kodë të komunës së veriut, e duhet të transferohet në 11 me kodë, dhe që i takon Komunës së Mitrovices së jugut. Ndërsa, duhet të themelohet një qender e re e votimit për shkak se lagjia e të “3 Rrokaqiejve”, lagjia “7 shtatori” kanë votuar në Suhudoll, ndërsa që i përketë si territor në bazë të ligjit, komunës së veriut. Kjo

nënkupton se në Suhudoll, mbetet qendra aktuale e votimit, por ndryshohet kodi: nga 38, në 11 dhe hapet një qender e re e votimit që (na kan propozuar sekretariati) për lagjet e lartpërmendura. Kjo, është bërë edhe në harmoni me dy komisionet komunale zgjedhore, dhe këshillin operacional zgjedhor. Prandaj, rekomandojmë KQZ-në që të marrë vendim të ndryshimit të qendrës së votimit në lagjen Suhudollë 38-11, dhe të themelimit e një qendre të re dhe në lagjen “3 Rrokaqiejt” që i përketë komunës së Mitrovicës së veriut...

Nenad Rikallo: Kjo, është një pyetje politike që folet e përfolet, dhe unë nuk e di se kujt i ka ra ndërmend që kjo pyetje si e këtillë për një pyetje kaq të ndishme politike që të diskutohet në KQZ. Njësitë katastrale komunale janë shumë të qarta, janë të ndara...Po hyjmë në një pyetje të ndieshme, pastaj ky dokument këtu nuk është në rregull...Ky document që është i nënshkruar nga persona të caktuar, duhet t'i ketë referencat e sakta...KOZ –i që e ka propozuar, unë nuk do të pajtohem, dhe mendoj që nuk mund të diskutojmë...

Betim Gjoshi: Kryetare, ndoshta më lejohet me folë jam që një kohë të gjatë në Komisionin Qendrorë Zgjedhorë edhe unë i kam lexuar letrat kesh në mbledhje të këshillit për operacione zgjedhore për as një takim të sodit që na nxuni para zgjedhjeve deri në momente tjera dhe i kërkojë ndjesë juve kryetarëve po mundohna me e jap kontributin tim këtu. Unë e di se çështja është edhe me diskutime politike në lidhje me kufinjë kadastralë, në mes 2 komunave edhe ne nuk jemi duke vendosur për kufinjë kadastralë që është tema tjetër. E dyta, është se nuk mendoj se mundemi me u marr si rast precedent për këtë çështje. E treat, në bazë të asaj që di, ne po vendosim ashtu qysh ka qenë në zgjedhjet lokale të vitit 2013, d.mth., nuk është bërë ndonjë ndryshim në zgjedhjet nacionale kena organizue për të mos me i mundue qytetarët për me i nda në 2 -3 qendra. Shqiptarët e Suhudollit, edhe ashtu ish dashtë me votu në very dhe pse: sepse e kishim fituar një asambleist më shumë. Dhe, e kishim pasur një gjasë ma të madhe për një kryetar komune më shumë...Në komunë të jugut, shqiptarë zgjidhen se jan 95 %, pra mendoj se nuk ka ndonjë motiv politikë...Problem është edhe në bazë të diskutimeve të kufijëve kadastralë dhe ne bazë të marrveshjes së Brukselit, Suhudolli është mbetë një vijë ndarjeje në Mitrovicë. Ne, çka na mbetet me zgjidhë po zgjidhim sotë: problemin e tre rrokaqiejëve të lagjes së Doktorëve të cilët, nuk kan qendër të votimit, d.mth, nuk kan ku me votue...

Ne, duhemi me e drejtue n'i qendër që nashta ata nuk e nijnë si të vetën, nuk e ndijnë të sigurtë dhe, kan kërkuar me pas një qendër të veten. Kjo, është kërkesa që mua m'u ka interpretuar prej disa përfaqësuesëve që unë i njohë në atë pjesë...Por, mbi te gjitha ne vendosim edhe sot në bazë të praktikes që kemi pasë në të kalumen. Ndërsa, kurdo që ka një marrveshje që i percakton kufinjët ndryshe, atje kena me ju pershtatë organizimit, bile për kufinjët e vitit 2013, neve na e ka dhënë një zgjedhje edhe Ministria e Pushteti Lokal, dhe se n ka siguruar se që çdo gjë është mbi bazë të gjendjes aktuale! Qysh organizohen në të ardhmen ne se dim, por edhe shkolla ku është qendra e votimit menagjohet nga Mitrovica e jugut. Edhe me taksa në pronë dhe të gjitha çështjet, për momentin i pergjigjen Mitrovices jugore. Kurdo që ka ndonjë ndryshim, ne kemi për detyrë me i respektuar çështjet kadastrale. Pra, unë nuk e besoj se dikush ka motive politike, këta e thash ma shumë për me i tregue kolegut tonë Nenad se, sepse kur vjen puna këtu te

problemet etnike, nuk kom qejf me pas ngjyrimet politike, d.mth., nuk dua të diskutoj kur ka ngjyrim politik...Edhe me Adnanin kur diskutoj në aspektin politik, të paktën, një pjesë të jetës sime, 18 vjet ende s'jam ba pjesë e lirisë së Kosovës me tamam, sepse e di se jam trajtuar si pakicë, dhe e di se çka do me thënë kur shumica nuk i jepë të drejtë pakicës...Me këtë rast, ky vendim i KQZ-së në asnjë variant nuk i rrezikon zgjedhjet ose, nuk ndërlihet me zgjedhjet sepse, impakti që kish me na rrezike n'i vendim eventual i këtyllë, kishim me i qitë banorët shqiptar në komunën e veriut ma shumë se tash...Po flasë pa dorza sepse në këtë rast nuk ka ndonjë politikë, ka një dëshirë të komunitetit dhe se nuk është shprehur kush ne krejt i kemi degët partisë atje, d.mth., me praktikën e kalume...dhe se, nuk po bëjmë kurgjo veç po i rikthejna zgjedhjet nacionale dhe rendi qysh u kanë në zgjedhjet lokale...Po i kërkoj falje shumë Nenadit se, po ia përmendi emrin disa herë por, e pata për me u shpjegue sepse, unë megjithatë nuk e di se çka është diskutuar në kshill...

Ky kshillë edhe ka diskutuar por, unë po e shpreh mendimin që kam në lidhje me këtë çështje, dhe besoj se isha i mjaft i qartë në diskutimin tim. Pra kjo është çështja që po e shqyrtojmë...

Eshref Vishi: Në këshill, nuk është diskutuar tjetër...! Kryesuesi, krejt çka është diskutuar, e tha...

Vadete Daka: E kemi kërkesën që kështu Lagjia Suhudollëve i poshtëm dhe Suhudoll i epërm dhe lagjia e Doktorrëve të mbesin në qendrën aktuale të votimit ku kanë votu edhe në shkollën fillore paralele "Avzi Sylejmani" që menagjohet edhe nga drejtorja e arsimit në Mitrovicën e jugut dhe ta marrë kodin e Mitrovicës së jugut sepse, ata ashtu e kështu votojnë në Mitrovicën e jugut...

Adnan Rrustemi: Janë dy mënyra për me vendos: mënyra ligjore dhe profesionale që neve na obilgon edhe ajo tjetra, politike...Unë nuk kursehem edhe për me diskutuar politikisht por, e dhashë rekomandimin në emër të kodit shumë profesional, d.mth., çështja është të qartë: në Suhudoll me ligje të kufirit administrative (ligjin mundet me e lexue secili, është në publik mundet me shkue, unë përmbi tavolinë e kam) janë të caktuara në komunë se cilat zona kadastrale i ka edhe Mitrovica e jugut. Qartë thotë se Suhudollit në zonë kadastrale, është me Mitrovicën e jugut, kurse zona kadastrale "Suhudoll i poshtëm dhe Suhudoll i epërm", është me Mitrovicën e veriut, e thotë ligji por s'po e thomë unë. Merreni hartën e zonave kadastrale të cilat, i kemi në dispozicion... T'i kufizon se ku fillon dhe ku përfundon ajo tjetra që çështja është se në Suhudoll kur deri tash ka qenë një qendër votime deri në fund të zgjedhjeve që e tha edhe Betimi, duhet me shëndrru nga 38 në 11, dhe me i taku komunës së Mitrovicës jugore...Ndërsa për votuesit e 3 lagjeve tjera dhe 2 lagjeve tjera që kanë votuar për shkak të sigurisë më tepër se sa lidhjes fizike në Suhudollë, e që me ligj i takon e që unë jamë në kuader politikisht të mitrovicës së veriut në këto komunë i takojnë Mitrovicës veriore këta e kanë një mundësi me votu sikurse për me e elaboru edhe në KKZ në 2 lagje tjera...por, që duhet gjithqysh me kalu nëpërmjet qytetit në veri...Por për shkaqe të sigurisë, e pamundëson dhe në një rast tjetër e thotë me kalu nëpër jug, por me kalu në veri...Edhe njëherë, ata kanë kërkuar me hap me të drejtë

një qendër votimi te 3 rrokaqiejtë, kurse sot ne e miratojmë Suhudollin në 11 (të jemi të qartë: Suhudolli i eperm apo i poshtum nuk ka banor – shiheni hartën..nuk ka asnjë banor), ashtu siç rekomandohet nga KOZ, dhe kurgjo tjetër ma shumë...

Valdete Daka: Faliminderit, nëse s’kemi kurgjo tjetër atëherë unë e kom të qartë: 3 rrokaqiejt janë pjesë e Mitrocies veriore, dhe 7 shtatori sepse unë e di...

Ercan Spat: Kështu, unë po nisem nga shpjegimi i kryesuesit të këshillit që e dha në detal, por mendoj se ne duhet të shohim se me “këto shpjegime”, me këto “fakte” ne e kemi shkelë ligjin e KQZ në Zgjedhjet Parlamentare sepse, një qendër votimi që i takon numri 11, ne e kemi nda në numrin 38...M’u për këtë shkak, unë e thash edhe në mbledhje të këshillit, do të abstenojë...

Nenad Rikallo: Kam një propozim që, çështja të bartet atje...Neve, na duhet një takim mes dy komisioneve: jugor dhe verior, dhe mendoj se duhet një koncensus, dhe besoj duhet një bashkëpunim i duhur...

Adnan Rrustemi: Unë mendoj që çfarëdo zvarritje, jepë dimension tjetër...Unë do të jem kundër, dhe do ta ndryshojë qasjen, sepse këtu është punë ligji...sepse, s’ka asgjë tjetër...Edhe në zgjedhjet e kaluara, ne i kemi trajtuar kundër ligjit...Ne, duhet ta themelojmë qendren e votimit te tre rrokaqiejt, me e shndërruar 38 në 11 dhe me vazhdu tutje...Pajtohem me Erxhanin plotësisht që ne e kemi shkelur ligjin dhe i kemi trajtuar gabimisht edhe në zgjedhjet e fundit...

Eshref Vishi: E drejta e votës nuk u është kufizuar sepse, Kosova është një zonë zgjedhore...

Betim Gjoshi: Ka të drejtë Erxhani, është shumë vërete se neve na vjen ma lehtë me i bo do punë, dhe tani po bëjmë kësi gabime...Unë për veti, jam t’u punue gjatë në analizë të votuesve në Kosovë...Çka kam gjetë janë shumë absurditete që përnjëmend është marre me na ardhur...Pra, nuk merret askush me këtë punë...! Rreth qendrave të votimit, aq shumë ka gabime sa është absurd...Veç po e marr një shembull në Prishtinë: E para, ne nuk kemi arritur me i bo numrat rend, e dyta, nuk kemi arritur me ua heqë do shkronja pa kurrëfar kuptimi... E treat, shiko çka na ndodh: 1901 qendra në Prishtinë, është lagja e Muhagjerëve dhe shkolla “Naim Frashëri” . Kurse, 1914 është esht prap qender votimi prap shkolla Naim Frashëri. Kurse 1914/e, është prapë qendër votimi në këtë shkollë! Raste të këtilla në Prishtinë janë nja 4 – 5... Në fakultetin Teknik po ashtu, janë dy” 907, dhe 908...

Jam ndalurt dhe i kam analizuar, tha z. Gjoshi, kam mendu mos janë të komunitetit...Dy qendra i kemi te “Ju programi”, tri qendra i kemi në Bërrnicë...Ka absurdite që kanë mbetë, dhe nuk e dinë as se si kanë mbetë...! I kanë lënë “Naim Frashërin” me një shkollë me pak votues, paramendoni në njërin rast në fakultetin teknik njëra qendër i ka 2500 votues, e njëra qendër 150 votues...Pra, hapet qender votimi: e votuesit shqiptarë...se, t’kishin qenë ata të ndonjë komuniteti tjetër, ok...do të thotë, ka shumë absurditete në nivel të Kosovës dhe ky është një rezultat që ne s’mundemi me e lëvizë...Për 10 vjet, ajo çka është lëvizë, është bërë nga anëtarët e KQZ-së...Me këtë punë, unë nuk duhet me u marrë, unë jam marrë për shkak të ankesave të

publikut...Unë, s'kam dalë me i thanë në media ankesat sepse, nuk due eme e damtuar insutucionin, mirëpo aq shumë ka mos besim në Listë votuese sa që gjenë shumë absurditete...Bile, ka në listë të votuesve njerëz që nuk janë të caktuar në qendra votimi hiq...Unë, e di se shërbimi përkates mundohet ç'mos me ba për me i orientue por, është tmerr, ka degradim nga Ministria e Punëve të Brendshme por, askush nuk e ngritë zanin dhe me i thënë se, e keni degraduar listën “prej 10.000 vetaave” në këtë komunë...Dhe, kjo s'është marre...! Ka grombullim të qendrave të reja...Kush vjen me u regjistru në 2 vjetët e fundit, krejt me një qendër i qojnë....!

Ne jemi duke e degraduar këtë process komplet, tha z. Gjoshi. Kjo çka po flasim në mes të “dy Mitrovicave”, kjo është një punë krejt e thjeshtë, kundrejt asaj që ne e kemi “problematikë” me zgjedhjet në përgjithësi...! Ne, kemi problematikë të ngjashme edhe në Killokotë, por çështja është se ne nuk mundemi me i trajtuar senet politikisht...Deshta me lyp afat, që d.m.th., që kjo që e kërkoi Rikallo me e mbështetë nëse e mbërrinë qëllimin dhe jam që kjo të bëhet me koncensus, por jo me u politizu...Sepse, unë jamë me e marrë vendimin si ka qenë në 2013...Nëse duhet me e hapë një qender votimi, ne u bëjmë sepse I kemi hapë nja 14 të tjera...E hapim, dhe njo nuk është problem por, po mendojna për kategori qytetare...I kena hapë edhe te Kamenica 2-3 qendra serbe me nga 70-80 votues... edhe u kanë i njejt fshat se, na kan than se po donë m'u kan ndamas prej shqiptareve...!

I kemi edhe në Lipjan qendrat etnike, tha z. Gjoshi, duke theksuar se nuk është adhurues i ndarjeve etnike. Në qoftë se, komuniteti i tyre dëshiron me pas ndarje, atëherë ja lejojmë, nuk është problem, por është mirë me i bashkue njerëzit e jo me i nda, tha Gjoshi. Unë mendoj se vendimi i sodit, është në kuadër të zbatimit të ligjit. Nëse mendon dikush që është në kundërshtim të ligjit, është mirë me n'a than saktë se përnjëmend, unë nuk e njoh mirë atë territory...Por, është mirë me na thanë se, këtu po shkelet ligji, ky nen i ligjit...! Por, mos të marrim vendime politike...Unë mendoj se, ne jemi në zbatim të ligjit, dhe jam mundu me u konsoltau me njerëz...Vetë, nuk jam i sigurtë me vlerësu sepse, është punë e ndishme...! Edhe shërbimi përkates, më ka thënë se kështu ka qenë në 2013, dhe unë i besojë shërbimit tonë...E kam pyetur shërbimin, dhe më kanë thënë se po e rikthejmë gjendjen qysh e kemi pasur më 2013...! Kështu, e ka bërë interpretimin edhe Ministria e Pushtetit Lokal...E marrim një vendim sot, dhe ne jemi këtu dhe, nëse ka diçka ndryshe unë kam me mbështetë Rikallon...

Binak Vishaj: Ne, kemi bërë një kërkesë në vitin 2013, e kemi lutë Ministrinë me na dhënë një sqarim se, këtë territor kush e adminstron...! Edhe e kemi shkresën, dhe se këtë territor e adminstron Mitrovica e jugut...Çdo kërkesë që është në funksion dhe që lidhet me kushtet ma të mira për votues dhe për qytetar, unë e përkrahu deri në një realitet tjetër që mundet me na qitë neve ndesh me këto që po o thotë Nenadi, Domethënë, Suhudolli menagjohet prej Mitrovicës së jugut dhe, e kemi me shkresë prej ministrisë që na u ka dhënë në vitin 2013.

Betim Gjoshi Nuk është në natyrën tonë por, e kisha shkruar një pasus, një nen në vendim që, “ky vendim” ka të bëjëvetëm për çështje të organizimit dhe të ndarjes së votuesve vetëm në

proceset zgjedhore, dhe se nuk ka efektet për proceset e tjera. Sepse, ne nuk dojmë me hy në zanat të kurrkujt, dhe nuk dom me i dëmtu proceset e tjetra...

Valdete Daka: Me këtë shtesën, kush është për këtë rekomandim të KOZ-it...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e KOZ –it.

Adnan Rrustemi: Mendoj që duhet të ketë vendim të shkruar për themelimin e qendrës së votimit të Rrokaqiejt, por s'ka nevojë për vendim për alokim të votuesve... sepse, kjo çështje kryhet "ex officio" në bazë të ligjit...

Nenad Rikallo: Unë, ajo që e kam propozuar ka pasur qëllim të mirë në mënyrë që njerëzit të cilët jetojnë atje të njihen, të barten dhe jo që KQZ t'ua imponojë atyre çështjet...sepse, ata janë të ndieshëm në këtë drejtim...Unë, u kam thënë që të bisedojnë lidhur me këtë mirëpo, kushdo që i pengon në këtë drejtim, reagimi është aty...Pra, propozimi im ka qenë që dikush nga komunat, zyrtarët tanë të ulen dhe të bisedojnë, të vijnë në KQZ dhe të diskutojmë dhe të sqarohet se çka është ligjore dhe çka nuk është...! Pra, të definohen çështjet dhe se asgjë të mos ketë prapavijë politike...Nëse këtë propozim timin e kuptoni si të qëllimshëm, atëherë me të vërtetë...

Sami Hamiti: Çështja është se, po flasim për një element për të cilin janë dhënë sqarime të shumta dhe të plota në KOZ: sa votues ka një zonë kadastrale, dhe nëse me zona kadastrale ndahen komuna dhe se ajo pjesë i bjen Mitrovices së jugut, s'ka nevojë fare me pyet kërkend sepse, kërkesa ka ardhë prej atij komuniteti...Ky komunitet, don me qenë ku është territorialisht...Në pjesën e Mitrovicës së veriut po hapet vendi për vendvotim, dhe se votuesit s'do jesisin të paknaqum por, k'ta e kanë kërkesën me votue ku janë sepse, don me qenë i kandiduem...Është e drjtë e ligjshme...Asgjë jashtëligjshëm nuk jemi t'u ba, dhe konscesueset në kundërshtim me ligjet nuk do bien...Prandaj, nëse konsiderohet dhe analizohet që është e jashtëligjshme edhe njëherë marrim vendim...Porse, tash është kohë e shkurtër...kërkesa është e drejtë, kurrfar konsensusi nuk duhet nëse territorialisht është në rregull...

Shqyrtim dhe miratimi i plotësim ndryshimeve të anëtarëve të KKZ-ve

Valdete Daka: Adnani paska dalë...! E kemi pasur planin dhe, sigurisht e keni shqyrtuar prandaj, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë plan të rekomanduar nga KOZ – i.

5. Komitetei i Auditimit:

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të KQZ-së për zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016

Binak Vishaj: Fillimisht, ju kërkojë falje sepse takimi i komitetit ka qenë në orën 11:00, dhe nuk kemi mbërri me e përkthye materialin... Sekretariati, e ka kriju një planë të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit Gjeneral...Këta janë edhe hartues po edhe implementus të këtij plani... Komitetei i auditimit të këtij plani do të jetë mbikqyrs, kurse KQZ – ja do t'i merrë vendimet... Në tabelë janë 13 rekomandime të cilat janë ndarë në fusha të auditimit...Prej tyre: gjashtë rekomandime janë me proritete të lartë, ndërsa shtatë me proritete të mesëm...

Betim Gjoshi: Raporti i auditorit, është më i butë se sa gjendja reale d.m.th., është fatë i rëndë që një pjesë e madhe e rekomandimeve janë të pa plotësime që katër vite. Po janë të përsëritura, dhe kjo është e precedan i veprës penale...e konsumon veprën penale nëse t'i, nuk bënë përpjeke minimale për me i zbatuar... Ka disa raste ku nuk varet prej vullnetit tonë të zbatimit të tyre se, s'ki buxhet të mjaftushuëm, se kanë kosto financiare... Rezultat i gabimeve menaxheriale, i mos vullnetit menaxherial menagjerial mos me u plotësu një varg rekomandimesh, kjo për mua d.m.th., i mbetet organeve të drejtësisë me vepru ose mos me vepru, por jo e konsumon veprën penale...Për mua, po, e miratojmë por kërkush këtu s'mundet m'u zotu me e implementu se, nuk është implementu deri më sot...Nëse nuk zbatohet plani, KQZ duhet me marrë masa...

Në bazë të informatave të komitetit të auditimit...Unë per veti, nëse nuk zbatohen, nëse KQZ nuk merrë masa, unë kam me e shqyrtue mundësinë mos me qenë ma në këtë komitet...Se, unë nuk jom atje organ vajtues d.m.th., nuk jena na ma veç me thanë se gjendja është keqe...Pra, janë disa çështje nuk po zbatohen dhe duhet me ditë fajtorin, me pa fajtorin në sy...Ama, ma nuk shkon kështu, që njëqindëherë unë e kam thënë këtë...Nëse prej neve është fajtori, kallxona ku është fajtori...! Nëse fajtori është jashta këtuhit, nëse nuk është jashta këtuhit po..., me kallxu ...! Janë do rregulla që duhet me i përmbush në komitetet të auditimit ...! Këtu po na del që kena të njëjtat vërejte... Unë, e kam thënë 100 herë: në administratë nuk ka masa me e rrehë dikendë, as shteti nuk rrehet d.m.th., kurse në raportin nërkombëtar t'i futë vërejtjet dhe t'i vlerësohesh si shtet jo kredibil...!

Për mua, tha z. Gjoshi, ky raport e nxjerrë Sekretariatit jo kredibil, domethënë që nuk i merrë seriozishtë vërejtjet e auditorit, nëse janë përsëritur 3, deri 4 herë... Janë të njëjtat vërejtje: te pagesat, te zotimi, te punësimi...mos të hyjë me i numëru tashti...! Nëse Sekretariati vlerëson se nuk ka nevojë për punëtorë, i drejtohet KQZ – së dhe I kërkon të shuhet vendet e punës... Nëse i nevojitet ushtrues detyre se po kryhen punët më mirë, e nxjerrim një rregullore që KQZ i kryen punët me ushtrues detyre...! Në këtë mënyrë..., duhet me u skuq pak...

Binak Vishaj: Është e vërtetë se edhe në komitet, domethënë rekomandimi 5 dhe 6, e kanë marrë shumicën e kohës debatet, sepse na u kanë përsëritë për herën e tretë, ose të katërt...Por,

unë mundem me thanë se, ne do t'a mbikqyrim planin dhe do t'i rrimë më afër planit të cilin e ka krijuar sekretariati...Sepse, përnjëmend është tepër shumëçka...

Valdete Daka: Unë, e kam vetëm një pyetje për Kryeshefin: Si afat kohor për implementimin për rekomandimin nr. 5-6 janë tetori dhe dhjetori, ne atëherë i kemi zgjedhjet lokale...Dhe përmbushja e këtyre rekomandimeve që 4 vite shtyhet me të njëjtat arsye...!

Do të thotë pse...?

Sami Hamiti: Trembëdhjetë rekomandime për këtë institucion, bajagi shumë janë për një institucion...Fakteqësia është se janë të përsëritshme...Gjatë aprovimit të rregulloreve, nese i implementon, gjysma e këtyre rekomandimeve bien: edhe te plotësimi i vendeve të punës, edhe te ZKF-ja që e futëm atje...Qyre si thotë: sa zotime ke me i krye deri në shtator... e, kemi edhe 1 muaj...E ke çështjen e zyrtarit financiar, te divizioni..qysh a përcaktue me rregullore, kush e ushtron...? Unë të kisha thënë kryetare: merre një shkresë kryetare dhe drejtojav... mbylle vetën... hiqe vetën prej këtyre seneve...

Ky se di çka shkruen hiq...A ke me e ndërrue rregulloren me të cilën, deri në shtator k'i me e ndërrue drejtorin e departamentit a çka I thotë që ka me qenë zyrtar kryesor financiar...Nuk është gabim...! S'mundet drejtoresha e administratës në të njëjtën kohë me qenë zyrtare kryesore financiare...! Mos bani hajgare...! Për këtë e përkraha Betimin, edhe tanë kohën po ta je psi vërejtje auditori, e ju po qitni "ligj mbi ligj"...! Të ka obligue deri në shtator...Është vepër penale nëse nuk e zbaton...

Ndëgjo edhe njëherë, iu drejtua z. Hamiti kryeshefit Hamili: këto rekomandime i ke në 2014, 2015, 2016, po vjen edhe 2017...! Pozicionin te financat shiqoje, këtu janë problemet kryesore...!

Enis Halimi: Te pasqyrat financiare, raporti është pa vërejte, pa theksim çështjesh, pa një opinion negative...! Nashta këtu n aka ikur, sepse këtu është synuar me thënë ka ndodh një process ndryshim me një vendim te KQZ-së, na e kemi hequr...

Sami Hamiti: A e di që dikush është ankuar në këshill të pavarur, a e dinë që e ka fituar atë lëndë...?

Enis Halimi: Jo nuk e di...!

Sami Hamiti: Vendimi i pavarur i këshillit gjyqësorë, është suprem, askush nuk mund të ndikojë, nuk mund ta ndërrojë...Ka bërë ankesë njeriu, dhe e ka fituar lëndën...

Enis Halimi: Tek unë, nuk ka ardhur asgjë...!

Valdete Daka: Afatet kohore: tetor, nëntorë...Nuk ka mundësi me u përmbushë, këto në s'kanë me u implementue...!

Sami Hamiti: Ndëgjo kryetare: deri më 15 janar 2018 kur t'i dorzojmë pasyqar financiare, ashtë afati i fundit...Këto janë ardhë 5 vjet me renë e s'i kemi emplimentu...

Betim Gjoshi: Kryetare, a bënë...? Vetëm afatin e fillimit lene menjëherë, sot me ja fillue, menjëherë...sa është data...?

Valdete Daka: Gusht, deri në dhjetor...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan fillimin e menjëhershëm të implementimit të rekomandimeve të Auditorit general.

Diskutim lidhur me rolin e OSBE-së në zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017

Valdete Daka: Na e dimë që OSBE na ka ndihmuar për zgjedhjet Parlamentare për katër komunat në veri, dhe ndihmën teknike për KKZ-të, si dhe për KVV-të...Unë, propozojë që ne ta bëjmë të njejtën kërkesë sepse, situata nuk ka naj ndryshim radikal prej 11 qeshorit...Unë mendoj që, të kërkojmë përsëri nga OSBE që ne të njejtën ta bëjmë për këto katër komuna...

Në këtë pikë diskutuan: Betim Gjoshi dhe Nenad Rikallo.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vazhdimin e ndihmës së OSBE-së në zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22 tetor 2017

Valdete Daka: Vazhdojmë me çështjen e asambleistëve...Së paku, unë kështu e kam të shënuar...!

Betim Gjoshi: I kam propozuar 2 pika...Realishtë për të dyja, duhet me pas konkluzion, dhe prapë në të ndryshme kam për të diskutuar...

E para, në në zgjedhjet e përgjithshme ne ua kemi dërguar listën e kandidatëve për deputet Ministris së Administratës Publike ose të Financave dhe ata në mënyr abirtrale, ua kanë ndal rrogat...Mbas fushatës, pse u ndalet rroga...?

Rekomandimi është që ne, mundemi me e dërguar një shkresë, unë e kam një rekomandim që t'ua drejtojmë institucioneve: kjo është lista e asambleistëve...Dhe, ata le ta shohin problemit, pra për t'u zgjidhur kjo çështje...Pra, kërkesa është që ne mos t'ua dërgojmë ministrisë së administratës, dhe ata të veprojnë sipas ligjit por jo që të dëmtohen por ta zbatojnë ligjin sepse, ne s'duhet të marrim pjesë në asnjë formë të dëmtimit të tyre...

E dyta, po na ndodhë me pas ndryshime në momentin e fundit të krijimit të listës...A e ka kontaktuar dikush MAPL-në me pyet se sa asambleista kanë komunat...! T'i drejtohem saktë...! Ne, duhet me ditë saktë që ne ti informojmë saktë...Kërkojë mbështetjen tuaj...?

Valdete Daka: Po i qes të dyjat...në votim...Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto dy kërkesat e propozuara nga z. Betim Gjoshi.

6. Të ndryshme

Betim Gjoshi: Dua të diskutojë rreth pagesave të komisionerëve...Jaën rreth 20 mijë komisionerë, dhe logjikishtë ndoshta rreth 3 mijë janë nga partia ime...Kjo, po më shkakton shumë problem me anëtarësinë...!

Unë, tha z. Gjoshi, KQZ e kam gjetur në vitin 2007 në këso gjendje si sot...! Por, ne kemi edhe detyrime dhe, pagesat nuk po bëhen...! Por, duhet ndryshue qasja e punës, duhet hequr përgjegjësinë sepse, kështu...

Enis Halimi: Ne, kemi bërë shkresën por nuk kemi hasur në mirëkuptim...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
